



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada – Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova – Kosovo Agency of Statistics

Indeksi i Kostos të ndërtimit TM4-2015

Indeksi i kostos të ndërtimit (IKN) / tremujori IV , 2015

Indeksi i tërësishëm i kostos të ndërtimit (IKN) në Kosovë po ashtu ka një rënie prej -1.4% në tremujorin e katër të vitit 2015 krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2015

Rënia e indeksit të çmimeve të kostos të ndërtimit është vërejtur te disa kategori si: rënia e çmimeve për -1.1% të materialet ndërtimore që ndikuan me -0.7%. Rënie e theksuar e çmimeve vërehet të transporti me -20% me një ndikim prej -0.8% në indeksin e tërësishëm .

Tremujori i katër 2015 / Tremujori i katër 2014

Krahasuar me periudhën e njëjtte të vitit paraprak (tm4 2015/tm4 2014), IKN-it po ashtu ka rënie për -0.4 %.

Rënia e Indeksit të çmimeve të kostos të ndërtimit është vërejtur te disa kategori si: rënia e çmimeve te materialet ndërtimore prej -1.1% me një ndikim prej -0.6 %, te transporti prej -20% me një ndikim prej -0.8%, si dhe kostot e tjera pësuan rënie prej -0.4% pa ndonjë ndikim në IKN.

Rënia e çmimeve u neutralizua me ngritjen e çmimeve të materialet elektrike 2.6 % me një ndikim prej 0.1%, te materialet hidro-sanitare prej 3.9 % me një ndikim prej 0.2 %, si dhe të energjia me 1.0 % pa ndonjë ndikim në IKN.

Shpjegim shtesë: Kalkulimi i Indeksit të kategorisë se **Energjisë** bëhet nga të dhënat e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit i cili është në përputhshmëri me klasifikimin standard të veprimtarive NACE rev .2, i cili është i bazuar në " Rregulloren nr. 11/2013 neni 7 .

Indeksi i Kostos të ndërtimit TM4- 2015

Tabela 1: Indeksi i kostos të ndërtimit për ndërtesat shumëkatëshe (TM1 2013=100)

Kodi	Kategoritë të kostove	Peshat	2013				2014				2015			
			tm 1	tm 2	tm 3	tm 4	tm 1	tm 2	tm 3	tm 4	tm 1	tm 2	tm 3	tm 4
1	Materialet (a+b+c)	69.8	100.0	100.1	100.4	100.0	100.0	99.8	99.4	99.4	99.1	99.9	98.9	
	a. Materialet ndërtimore	60.4	100.0	100.2	100.6	100.4	100.4	100.2	99.7	99.4	99.1	99.8	98.6	
	b. Materialet elektrike	5.1	100.0	99.4	99.3	99.1	97.8	97.8	97.8	98.8	98.8	100.3	100.3	
	c. Materialet hidro-sanitare	4.3	100.0	99.6	99.5	99.4	97.2	97.2	97.2	99.6	99.6	101.0	101.0	
2	Pagat	16.4	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.2	100.2	104.4	104.4	104.4	
3	Makineritë	5.9	100.0	100.0	100.0	100.0	100.7	103.0	103.1	104.6	104.6	104.8	105.0	
4	Transporti	3.8	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	80.0	
5	Energjia	1.4	100.0	95.0	94.9	103.1	103.3	100.3	101.2	115.4	115.4	116.1	116.2	
6	Kostot e tjera	2.7	100.0	99.1	98.7	99.5	100.2	99.5	99.7	99.6	99.8	99.1	98.8	
	Total (1+2+3+4+5+6)	100.0	100.0	100.0	100.2	100.0	100.1	100.2	100.1	100.1	100.6	101.1	99.7	

Tabela 2: Indeksi i kostos të ndërtimit për ndërtesat shumëkatëshe (Tm4 2015)- ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje


Kodi	Kategoritë të kostove	Mesatarja viti 2014	tm 1 - 2014	tm 2 - 2014	tm 2 - 2014	tm 3 - 2014	tm 3 - 2014	tm 4 - 2014	tm 4 - 2014
			tm 4 - 2013	tm 1 - 2013	tm 2 - 2013	tm 2 - 2014	tm 3 - 2013	tm 3 - 2014	tm 3 - 2014
1	Materialet (a+b+c)	99,8	0,0	0,0	-0,1	-0,2	-0,6	-0,5	-0,6
	a. Materialet ndërtimore	100,2	0,3	0,0	0,2	-0,2	-0,3	-0,5	-0,4
	b. Materialet elektrike	97,8	-1,3	0,0	-1,6	0,0	-1,5	0,0	-1,4
	c. Materialet hidro-sanitare	97,2	-2,3	0,0	-2,4	0,0	-2,4	0,0	-2,3
2	Pagat	100,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,2	0,2
3	Makineritë	102,9	0,7	2,3	3,0	0,1	3,1	1,4	4,6
4	Transporti	100,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
5	Energjia	105,0	0,2	-2,9	5,6	0,9	6,6	14,1	11,9
6	Kostot e tjera	99,7	0,7	-0,7	0,4	0,2	1,0	0,0	0,1
	Total (1+2+3+4+5+6)	100,1	0,1	0,1	0,2	-0,1	-0,1	0,0	0,0

Indeksi i Kostos të ndërtimit TM4- 2015

Tabela 2: Indeksi i kostos të ndërtimit për ndërtesat shumëkatëshe (Tm4 2015)- ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje (vazhdim)

Kodi Kategoritë të kostove	Mesatarja viti 2014	tm 1 - 2015	tm 1 - 2015	tm 2 - 2015	tm 2 - 2015	tm 3 - 2015	tm 3 - 2015	tm 4 - 2015	tm 4 - 2015
		tm 4 - 2014	tm 1 - 2014	tm 1 - 2015	tm 2 - 2014	tm 2 - 2015	tm 3 - 2014	tm3- 2015	tm4- 2014
1 Materialet (a+b+c)	99.8	0.0	-0.6	-0.3	-0.9	0.8	0.0	-1.0	-0.5
a. Materialet ndërtimore	100.2	-0.3	-1.0	-0.3	-1.3	0.6	-0.5	-1.1	-1.1
b. Materialet elektrike	97.8	1.1	1.0	0.0	1.1	1.6	2.6	0.0	2.6
c. Materialet hidro-sanitare	97.2	2.4	2.4	0.0	2.4	1.5	3.9	0.0	3.9
2 Pagat	100.0	0.0	0.2	4.2	4.4	0.0	4.4	0.0	4.2
3 Makineritë	102.9	0.0	3.9	0.0	1.5	0.2	1.6	0.2	0.4
4 Transporti	100.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	-20.0	-20.0
5 Energjia	105.0	0.0	11.7	0.6	15.8	0.1	14.9	0.3	1.0
6 Kostot e tjera	99.7	0.1	-0.4	-0.7	-0.4	-0.3	-0.9	0.4	-0.4
Total (1+2+3+4+5+6)	100.1	0.0	0.0	0.5	0.4	0.5	1.0	-1.4	-0.4

Figura 1: Zhvillimi i IKN,TM1 2013 – TM3 2015 (TM1 2013=100)



Indeksi i Kostos të ndërtimit TM4- 2015

Përshkrimi metodologjik i Indeksit të Kostos të Ndërtimit për ndërtesat shumëkatëshe

Indeksi i Kostos të Ndërtimit matë zhvillimin e çmimeve të faktorëve të prodhimit të materialit të lëndës së parë, pagat, makineritë, transportin, energjinë dhe kostot e tjera që përdoren në projektet ndërtimore. Indeksi matë ndryshimin e çmimit për faktorë individualë të prodhimit dhe i peshon ato në përputhje me një sistem matës të vendosur. Indeksi nuk matë ndryshimet e produktivitetit siç janë shfrytëzimet më të mira të materialeve apo faktorë të tjerë, dhe as nuk pasqyron margjinat e tij të profitit.

Popullsia

Indeksi i Kostos të Ndërtimit është i kufizuar vetëm në ndërtesat e reja shumëkatëshe. Arsyeja për këtë është se ka një projekt të njësuar ndërtimor në Kosovë, por edhe sepse kjo kërkohet si indikator afatshkurtër edhe nga EUROSTAT-i.

Indeksi kalkulohet për tërë territorin e Kosovës.

Kategoritë e Kostos

Indeksi i kostos të ndërtimit për ndërtesat shumëkatëshe përfshinë gjashtë kategori të kostos si në vijim:

- Materialet
- Pagat
- Makineritë
- Transport
- Energjia
- Kostot e tjera

Indeksi i Kostos të ndërtimit TM4- 2015

Indeksi model

Indeksi model që përdoret për indeksin e koston të ndërtimit është indeksi model *Laspeyres*.

I_{ot} = numri i indeksit në një moment të kohës, t (koha e krahasimit) ku numri i indeksit në pikën e kohës është 0 (pika bazë në kohë) është 100

p_t^i = çmimi për njësi në kohë t

p_0^i = çmimi për njësi në pikën në kohë 0

w_0^i = Pesha e produktit i në pikën bazë të kohës

$$I_{ot}^L = \frac{\sum_{i=1}^n \left(\frac{p_t^i}{p_0^i} \times w_0^i \right)}{\sum_{i=1}^n w_0^i} \times 100$$

Informatat për të gjitha çmimet p_i (për secilin produkt $i=1, \dots, n$) për secilën situatë t mblidhet kur përdoret L-indeksi, ndërsa informata për vlerën e peshës w kalkulohet vetëm për pikën bazë të kohës.

Arsyeja pse përdoret ky model i indeksit të ndërtimit është sepse është e pamundur të përdoret *Paasche* apo formula e indeksit zinxhiror nga pikëvështrimi i kalkulimit teknik, meqë vlerat e peshimit mund të përditësohen vetëm pas disa vitesh. Prandaj për të prodhuar vazhdimisht një indeks të përditësuar të çmimit të faktorëve, formula *Laspeyres* jep një zgjidhje të duhur.

Mbledhja e të dhënave

Çmimet për materialet ndërtimore janë mbledhur nga furnizuesit e materialeve ndërtimore. Këta furnizues drejtpërsëdrejti merren me kontraktues. Për të mbledhur informata për çmimet, një formular-dokument u dërgohet kompanive ku ASK në mënyrë specifike tregon se për çfarë produkti po mblidhen informatat për çmimet. Ata të cilët i japin këto të dhëna mund të shohin se çfarë çmimesh kanë dhënë në ASK në tremujorin paraprak. ASK kërkon mesataren e çmimeve që kompanitë kanë për produktet e tyre çdo tre muaj.

Kostot e pagave mblidhen nga kompanitë ndërtimore.

Për kostot e makinerive, ASK mbledhë çmimet për makinat e vogla që përdoren në sektorin e ndërtimtarisë.

ASK mbledhë çmimet për transportin për shërbimet e transportit të materialeve ndërtimore nga disa kompani logjistike.

Kostot e energjisë mblidhen nga Indeksi i Çmimit të Prodhimeve në kuadër të ASK.

Të dhënat për kosto të tjera mblidhen nga Indeksi i Çmimeve të Konsumit në kuadër të ASK.

Indeksi i Kostos të ndërtimit TM4- 2015

Pesha

Pesha për Indeksin e Kostos të Ndërtimit bazohet në pyetësorin e kompanive të ndërtimit. Peshat e reja përdorën nga tremujori i parë i vitit 2013; tremujori i parë i 2013 është gjithashtu periudha bazë e indeksit.

Përdorimi i Indeksit të Kostos të Ndërtimit

Indeksi i Kostos të Ndërtimit për ndërtesat shumëkatëshe është indikator i rëndësishëm për palët e interesit, si dhe për analizën e sektorit të ndërtimitarisë. Mund të përdoret edhe si deflator i çmimeve tek llogaritë kombëtare për ndërtimin e ndërtesave shumëkatëshe.

Publikimi i rezultateve

Rezultatet e indeksit të kostos të ndërtimit publikohen në ueb faqe të ASK-së në internet çdo tre muaj.

Publikimi është përgatitur nga:

Illir T.Berisha – Drejtor i Departamentit Ekonomik
Ibish Asllani – Shef i Divizionit
Arlinda Mataj – Zyrtare e lartë

Mars, 2015

Kryeshef Ekzekutiv,ASK
Isa Krasniqi

Informata për kontakt në Agjencinë e Statistikave të Kosovës

- Adresa: Agjencia e Statistikave të Kosovës, rruga Zenel Salihu, nr. 4, Prishtinë
- Telefonat:
Zyra Qendrore: +381 (0) 38 200 31 104
Drejtori: +381 (0) 38 200 31 112
- Fax: +381 (0) 38 235 033
- E-mail: economic@rks-gov.net
- Faqja e internetit: www.ask.rks-gov.net